



Pranimar / Dorezuar Prilidhen / Prilidhet Received / Delivered	01.12.2022	viti god year	2022
Organ / Pjesista Org / Unit	Nr Prot (Nr Prot Prot No)	Shtypje e Protog Appendix	Sasia Kohëzina Quantity
SKIMSHICK	7582/2022		1/5



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.881/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtar, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.881/2022 të datës 07.10.2022 të parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_ përfaqësuar nga Avokat \_\_\_\_\_ me adresë:

\_\_\_\_\_ kundër organit të punësimit Agjencisë për Informim dhe Privatësi, në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1.nenin 16 paragrafi 3 ,nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 01.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

**I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.881/2022 e datës 07.10.2022 e parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_**

**II. Obligohet Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, t'ia bëjë plotësim ndryshimin e aktit të emërimit të ankueses të datës 01.04.2019, ashtu që koeficienti i ankueses sipas aktemrimit të ri të jetë nëntë (9).**

**III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.**

A r s y e t i m

Ankuesja \_\_\_\_\_ e cila sipas shkresave të lëndës është e punësuar në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, për shkak të heshtjes administrative nga institucioni punëdhënës lidhur me



kërkesën e saj të datës 23.06.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datë 07.10.2022 me pretendimet ankimore se e njëjta është duke u diskriminuar pasi që sipas aktit të emërimit mban pozitën "Zyrtare Çertifikuese" dhe vazhdon të paguhet sipas koeficientit tetë (8), ndërsa sipas shkresës së Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil e datës 27.11.2014 me numër:6038, institucioni duhet ta paguajë ankuesen sipas koeficientit nëntë (9), me kërkesën që Këshilli t'ia njoh edhe pagesën në mënyrë retroaktive nga data 01.04.2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 13.10.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses tek Agjencia për Informim dhe Privatësi. Ndërsa me datën 21.10.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit, me datë 15.11.2022 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë Vendimin VK.nr.150/2022 përmes të cilit ankesës së ankueses A.nr.881/2022 të datës 07.10.2022 i është shtyrë afati për vendimmarrje edhe për dhjete (10) ditë pune.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore administroj këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 5976/2022 të datës 07.10.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshill; Kërkesa për nivelizimin e koeficientit e parashtruar në Agjencinë për Informim dhe Privatësi e datës 23.06.2022; Autorizim i datës 04.10.2022; Kërkesa për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 6152 e datës 13.10.2022; E-mailit i dërguar nga A.S drejtuar F.G e datës 21.10.2022; Përgjigja në ankesës me numër të protokollit 6368/2022 datës 21.10.2022; Vendim i KPMSHCK me numër të protokollit 5337/2022 e datës 12.09.2022; E-mail i dërguar nga A.S drejtuar B.S e datës 24.06.2022; Shkresë e lëshuar nga Ministria e Administratës Publike/Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil e datës 20.11.2014; akt emërimi për me nr.prot.AE/020-2017 e datës 08.05.2017; Plani i veprimit lidhur me rekomandimet e Auditorit për vitin 2017 me numër të referencës 26/2018 e datës 23.05.2018; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit i datës 01.04.2019; Akt emërimi me nr.prot.AE/009-2019 e datës 15.07.2019; Akt emërimi me nr.prot.AE/006-2022 e datës 26.04.2022; Shkresë- Mendim Këshillimor me nr.prot.1795 e datës 20.10.2021; Mendim Këshillimor për Projekt-Rregulloren për Organizimin e brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë për Informim dhe Privatësi me nr.0747/2021 e datës 25.11.2021; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën e shpallur sipas konkursit e datës 26.04.2022; Konkurs me të referencës ASHMDHP-ZDP-003 për pozitën "Zyrtar Administrativ"; Lista e Konkurseve të paraqitura ne SIMBNJ e datës 03.11.2017; Detajet e përshkrimit të punës për pozitën Zyrtar Certifikues prej 1-3 faqe; Organogrami; Struktura dhe Pozicionet e Agjencisë për Informim dhe Privatësi e paraqitur përmes tabelës prej 1-2 faqe.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga shkresat e administruara të lëndës, respektivisht në bazë të Akti të Emërimit të datës 01.04.2019, ka konstatuar se ankuesja e mban pozitën "Zyrtar Çertifikues" në kuadër të Agjencisë për Informim dhe Privatësi dhe paguhet sipas koeficientit tetë (8), ndërsa e njëjta me datë 23.06.2022 ka parashtruar kërkesë te Zëvendësuesi i





Drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë për Informim dhe Privatësi lidhur me harmonizimin e koeficientit, kërkesë e cila me datë 24.06.2022 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Informim dhe Privatësi është përcjellë tek Menaxherja e Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, e cila pastaj me datë 24.06.2022 kërkesën e ankueses e ka përcjell me te Drejtori i Departamentit Ligjor i cili nuk kishte dhënë ndonjë rekomandim se si të veprohej.

Ankuesja e pa kënaqur me mungesën e përgjigjes nga institucioni punëdhënës lidhur me kërkesën e saj të datës 23.06.2022 për harmonizimin e koeficientit, me datë 29.07.2022 kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli me datë 12.09.2022 kishte nxjerrë Vendimin A.nr.676/2022 dhe numër protokolli:5337/2022 përmes të cilit ankesën e ankueses të datës 29.07.2022 e kishte hedhur poshtë si të palejuar, respektivisht Këshilli nuk ishte lëshuar në shqyrtim meritor për ankesën në fjale, ngase e njëjta ishte parashtruar në kundërshtime dispozitat e Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenin 127 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *"Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ"* ndërlidhur me nenin 98 paragrafin 1 dhe 2 i të njëjtit ligj, ku përcaktohet se: 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.* 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj".*

Ankuesja, pas pranimit të Vendimit të Këshillit A.nr.676/2022 përmes të cilit ishte hedhur poshtë si e palejuar ankesa e datës 29.07.2022 për arsyet e dhëna ligjore si më lartë, ndërsa me datë 07.10.2022 e njëjta ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se janë plotësuar kushtet ligjore në kuptim të nenit 98 dhe nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative që ankesa e ankueses të shqyrtohet meritorisht duke e aprovuar kërkesën për ngritjen apo harmonizimin e koeficientit nga tetë (8) në nëntë (9) pasi që e njëjta sipas Aktit të Emërimit të datës 01.04.2019 mban pozitën *"Zyrtare Çertifikuese"* dhe se sipas shkresës së datës 27.11.2014 të Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil lidhur vendosjen e koeficientëve sipas pozitës, pozita të cilën e mban ankuesja duhet të paguhet sipas koeficientit 9 (nëntë), citoj: *"-për udhëheqës të divizionit në kuadër të departamentit në ministri dhe zyrtarët certifikues të vendoset koeficienti nëntë (9)."*

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueses, ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenin 98 paragrafin 1 dhe 2, ku përcaktohet se: 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.* 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj",* si dhe nenin 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *"1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.* 4. *Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ",* dhe ka ardhur në përfundimin se ndërlidhur me kërkesën e ankueses të datës 23.06.2022, dita e fundit për afatin e vendosjes prej katërdhjetë e pesë (45) ditësh nga institucioni punëdhënës sipas dispozitave të nenit 98 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për



Procedurën e Përgjithshme ka qenë data 07.08.2022, prandaj në kuptim të nenit 127 paragrafi 4 i të njëjti ligj, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankues e parashtruar në Këshilli me datë 07.10.2022 është parashtruar brenda afatit të përcaktuar ligjor për heshtjen administrative, rrjedhimisht ankesa e ankueses është e pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses lidhur me harmonizimin e koeficientit për pozitën "Zyrtare Çertifikuese", Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 9 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, ku përcaktohet se: "*Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës*", si dhe nenin 3 paragrafi 2. Ligji nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ku përcaktohet se: "*2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë*" sikurse e ka analizuar edhe nenin 19 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik i cili rregulloj të drejtën të drejtën e pagës dhe shpërblimit të drejtë, e që specifikisht përcakton se: "*Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave.*"

Po ashtu, në bazë të shkresës me numër të protokollit:6038 të datës 27.11.2014 të lëshuar nga Drejtori i DASHC-së, i Ministrisë së Administratës Publike, është konstatuar po ashtu se për pozitën "Zyrtar Çertifikues" koeficienti duhet të jetë nëntë (9), andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se organi i punësimit është i obliguar që të veprojë në pajtim me dispozitat e lartcekura ligjore, si dhe ankueses obligohet t'ia bëjë ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit, duke i ndryshuar koeficientin nga tetë (8) në nëntë (9), ngase organi i punësimit është i obliguar që të veprojë në këtë mënyrë me qëllim të zbatimit të nenin 3, paragrafi 2. Ligji nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ku përcaktohet se: "*2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë*", sepse në bazë të shkresës së lartcekur të Ministrisë së Administratës Publike, me nivelin e pozitës dhe përshkrimin e detyrave të punës, është konstatuar se për pozitën "Zyrtar Çertifikues" koeficienti duhet të jetë nëntë (9), dhe të bëhet trajtimi për të gjithë nëpunësit civil në mënyrë të barabartë që mbajnë pozitën e lartcekur, ndërsa ankuesja deri në momentin e parashtrimit të ankesës në Këshill për punën e njëjtë ka qenë duke u paguar me koeficient tetë (8).

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, thekson faktin se organi i punësimit Agjencia për Informim dhe Privatësi, pas pranimit të Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e obliguar që ankueses t'ia bëjë Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit sipas të gjeturave në arsyetim e këtij vendimi, pra t'ia harmonizojë koeficientin sikurse është e përcaktuar për pozitën "Zyrtar Çertifikues", respektivisht duke ia ngritur nga tetë (8) në nëntë (9).

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimore të ankueses që kompensimi t'i bëhet në mënyrë retroaktive për dallimin e pagesës për një (1) koeficient nga periudha kohore 01.04.2019, Kolegji i Këshillit thekson faktin se në kërkesën e ankueses të datës 23.06.2022 të parashtruar në institucionin punëdhënës nuk e kishte specifikuar edhe kërkesën për kompensimin në mënyrë retroaktive, ndërsa për mungesën e pranimit të përgjigjes apo heshtjes administrative që ndërlidhet me kërkesën e saj të datës 23.06.2022 ka parashtruar ankesë në Këshill. Po ashtu, Kolegji i Këshillit sjellë në vëmendje se ankuesja kundër Aktit të Emërimit të 01.04.2019 nëse ka qenë e pakënaqur ka mundur të



parashtrrojë ankesë të brendshme sipas dispozitave të aplikuara gjatë asaj kohe sa ka qenë në zbatim ligji tjetër material, respektivisht Ligji Nr.03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, andaj mbi këtë bazë pretendimi i saj ankimor për kompensim në mënyrë retroaktive të diferencës në koeficient nuk mund t'i aprovohet.

Andaj, bazuar në këto rrethana, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit të përcaktuar me nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.881/2022 e datës 01.12.2022

Flakron Gashi



Zyrtar i Lartë për bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësueses së ankueses, Avokate-
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Informim dhe Privatësi;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.